



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 3, datë 26.02.2014

**P Ë R**

**“DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.2, DATË  
30.03.2009 MBI “MIRATIMIN E RREGULLORES, PËR ORGANIZIMIN DHE  
FUNKSIONIMIN E SHËRBIMIT TAKSI NË QYTETIN E TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 2, nenit 32, shkronja “k” dhe nenit 33, pika 2 të ligjit 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); nenit 128 të ligjit nr.8485, date 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr.2, datë 30.03.2009 mbi “Miratimin e rregullores, për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në qytetin e Tiranës”, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Transportit dhe Lëvizshmërisë dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë disa ndryshime në vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 2, datë 30.03.2009 mbi “Miratimin e rregullores, për organizimin dhe funksionimin e shërbimit taksi në qytetin e Tiranës, si më poshtë:

**Pas nenit 36 shtohet nenit 36/1 me këtë përmbajtje:**

**Neni 36/1**

1. Për të gjithë subjektet e shërbimit taksi që do të rinovojnë licencën nga periudha gjatë vitit 2014, vetëm për plotësimin e kriterit të përcaktuar në nenin 39 në lidhje me vitin e prodhimit të automjetit, afati i përmbushjes së tij shtyhet me dy vite kalendarikë.
2. Subjektet, të cilat do të përfitojnë nga përcaktimi i sipërpërmendur detyrohen të paraqiten 30 ditë para përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 1 të nenit 36/1, pranë Qendrës së Regjistrimit dhe Licencimit për ndryshimin e mjetit sipas përcaktimeve të nenit 34 të rregullores.

**Në nenin 73 të rregullores shtohet pika 4:**

- 4.Subjekti i licensuar nuk plotëson detyrimin e parashikuar në nenin 36/1, pika 2.

**Në nenin 75 pas paragrafit të parë shtohet paragrafi i mëposhtëm:**

Përfshihen nga detyrimi për ndërrimin e mjetit, subjektet e parashikuara në nenin 36/1 të kësaj rregullore dhe sipas përcaktimeve të tij.

2. Ngarkohet Drejtoria e Transportit dhe Lëvizshmërisë, Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit/Qendra e Regjistrimit dhe Licencimit të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R**

**ALDRIN DALIPI**